

Për një komunitet pa drogë dhe alkool!



Koalicioni CADA-10 është krijuar në kuadër të bashkëpunimit të YWCA of Albania me CADCA, me qëllim angazhimin e strukturave të komunitetit për parandalimin e varësisë ndaj drogës dhe alkoolit.

CADA-10, ka si qëllim angazhimin e sa më shumë përfaqësuesve të komunitetit me qëllim parandalimin e abuzimit të drogës dhe alkoolit, nëpërmjet:

- ◆ dëgjimit të nevojave të tyre dhe identifikimit të vështirësive
- ◆ promovimit të rolit të tyre në krijimin e një shoqërie të shëndetshme
- ◆ ofrimit të shërbimeve nga profesionistë të fushave të ndryshme
- ◆ komunikimit të mesazheve në mënyra kreative
- ◆ trajnimit të aftësive ndërpersonale dhe zgjidhjes së konflikteve
- ◆ rritjes së ndjenjës së përkatësisë në grup


“Çfarë është varësia? Është një shenjë, një sinjal, një simptomë e përballjes me shqetësimin dhe dhimbjen e vazhdueshme! Është një gjuhë që na tregon për një gjendje të vështirë që duhet kuptuar.”

12 sektorët e kërkuar për Programin e Mbështetjes për Komunitetet pa Drogë Koalicionet e KPD duhet të përfshijnë minimalisht një anëtar/përfaqësues nga secili prej këtyre 12 sektorëve të komunitetit:

- Të rinj
- Prindër
- Komuniteti i biznesit
- Media
- Shkollat
- Organizata rinore
- Agjenci ligj-zbatuese
- Organizata fetare apo vëllazërore
- Grupe qytetare apo vullnetare
- Profesionistë të kujdesit shëndetësor
- Agjenci shtetërore apo lokale me ekspertizë në fushën e abuzimit me substancat
- Organizata të tjera

Ka një sërë faktorësh që i shtojnë të rinjtë drejt abuzimit me substancat. Këta faktorë mund të jenë njëkohësisht mbrojtës dhe rrezikues.

- ❖ vetëkontrolli kundrejt prirjes drejt sjelljeve devijante dhe agresive
- ❖ monitorimi dhe kujdesi prindëror kundrejt konflikteve
- ❖ angazhimi në aktivitete kuptimplota kundrejt abuzimit nga rrethi shoqëror
- ❖ politikat e qarta kundër varësisë kundrejt lehtësisë për të gjetur substanca
- ❖ krijimi i lidhjeve të ngushta kundrejt komuniteteve të rrezikshme



Bashkohu edhe ti me CADA-10!

KONTAKTO NË:

 cada.10

Tel: 042271642

 Koalicioni Cada